Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***23.03.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***31.03.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***66/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:22.03.2022, OE ankues **"Kastrati -L"-Drenas**, ka parashtruar ankesë me nr: **66/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorve ekonomik **"Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Mirembajtja e deponis Inerte",*** me nr.të prokurimit**:** 611-22-293-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna Gllogoc.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë – punë me një operator ekonomik, vlera e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 35 000,00 €

Data e njoftimit për kontratë 26/01/2022, Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 18.02.2022, Njoftimi per vendimin e AK-së, 07.03.2022, kërkesa për rishqyrtim 10.03.2022, vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 14.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë

Neni 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së , si dhe Ligjin Nr. 04/L-60 për Mbeturinat

Neni 4, parag 1, nen par. 1.23

Neni 6, Llojet e mbeturinave

Neni 7, Klasifikimi i mbeturinave

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Të pa kënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 07.03.2022, dhe vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës 14.03.2022, atëherë brenda afatit ligjor parashtrojmë ketë Ankese me pretendimet se AK, ka bere shkelje te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë

> Neni 1, Qëllimi,

> Neni 7, Barazia në trajtim/Jo-Diskriminim,

> Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

> Neni 60, Kriteret për dhënie të kontratës;

> Neni 69, Aftësitë teknike dhe/ose Profesionale,

Dhe Ligjin Nr. 04/L-60 për Mbeturinat

> Neni 4, parag 1, nen par. 1.23

> Neni 6, Llojet e mbeturinave

> Neni 7, Klasifikimi i mbeturinave

Neni 1, Qëllimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për te eliminuar ofertën e Operatorit Ekonomik "KASTRATI-L" NEKOC-DRENAS, nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se tenderi i kësaj kompanie është i pa përgjegjshëm në kuptim te dispozitave te LPP-se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të LPP-se.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 1. paragrafi 1 te këtij ligji

CITOJME: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të

shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Nëse i referohemi Vendimit te Autoritetit kontraktues do të shohim se, çmimi i ofertuar i ofertës nga OE: "KASTRATI-L" NEKOC-DRENAS është 28,944.50€ dhe, është çmimi me i ulte ne raport me çmimin e OE te propozuar për kontrate të konsorciumit GR OE "HAZIR TERDEVCI B.I & PROGRESI L.L.C" DRENAS i cili GOE është shpërblyer me kontratë ne vlere prej 29,837.50€, me që rast Autoriteti kontraktues me ketë veprim dëmton buxhetin e varfër e republikës se Kosovës të dhe te Komunës se Drenasit i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve te komunës, demi që do të shkaktohet është ne shumen prej 983.00€.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se AK-Komuna Drenasit me vendimin e vet për te shpërblyer me kontrate ofertën e GOE i cili për nga çmimi është me i lartë, se Oferta jonë ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1, nenin 59 dhe 60 te LPP-se.

> Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka bere shkelje te dispozitave te nenit 7 te LPP-se duke mos i trajtuar ne mënyre te barabarte te gjithë Operatoret ekonomik, pjesëmarrës ne tender.

Pabarazia në trajtim, favorizimi i një operatori dhe diskriminimi i operatoreve tjerë, që është bere nga ana e AK në procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes së Operatoreve Ekonomik me rastin e vendimit për shpërblim të kontratës është shkelje e nenit 7 të LPP-se.

Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues qe gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit te tenderëve të i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Faktet dhe argumentet:

a) Kërkesa në Njoftimin për kontrate III.2.2 dhe në dosje të tenderit 7.1 & 7.2, Është kërkuar: Licencë për menaxhim të mbeturinave ose Kontrate për deponim te mbeturinave me një kompani te Lincensuar-valide

b) Dëshmia: OE duhet të jetë i lincencuar me licencë për menaxhim te mbeturinave - leshuar nga Ministria e planifikimit Hapesinor dhe Mbrojtjes se Mjedisit ose kontrate për deponim te mbeturinave me një kompani te licencuar për menaxhim te mbeturinave-kopje.

Bazuar ne dëshmitë dhe faktet e cekura me larte mund te shihet qarte se, AK ka bere diskriminim dhe trajtim te pa barabart ne mes te OE, për faktin se ka favorizuar me vedije

GOE HAZIR TERDEVCI B.I & PROGRESI L.L.C" DRENAS dhe diskriminuar OE "KASTRATI-L" NEKOC-DRENAS.

Ketë shkelje të nenit 7 të LPP-se e arsyetojmë me faktin se AK na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se Mungon Licenca e OE te cilën e ka ne Kontratatë, i cili arsyetim nuk është i vërtet, për me tepër dhe sipas kërkesës se juaj vetë Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), Ju ka përcjellë shkresën e MMPHI, e cila në pasuesin e fundit, thuhet: Se, pasi marrja e lejes se integruar merre kohë Ju duhet të vazhdoni me punue komfor ligjeve në fuqi si ndërmarrje e ligjshme deri në një vendim tjetër nga MMPHI. Kjo dëshmon se Kompania jone posedon License nga Autoriteti i nivelit Qendror- Institucional, dhe, pavarësisht kësaj shkrese zyrtare të KMDK SH. A, Prishtine, AK, KK Drenas na eliminon nga Aktiviteti i Prokurimit dhe ne anën tjetër shpërblen me Kontratë GOE "HAZIR TERDEVCI B.I & PROGRESI L.L.C" DRENAS të cilët posedojnë kontrate me kompaninë rajonale "Uniniteti" e nivelit lokal për të cilën është ofruar Licencë për mbledhjen e mbeturinave komunale lokale, por JO inerte.

Detaje tjera:

Kompani "Kastrati - L" e konteston Licencën e ofruar nga OE "Progress" i cili ka kontratë me KRM "UNITETI", pasi që Licenca për administrimin e mbeturinave nga KRM "Uniteti" nuk është licencë për menaxhimin e mbeturinave inerte për arsye se:

Në Ligjin Nr. 04/L-60 për Mbeturinat është e definuar dallimi i llojeve të mbeturinave dhe deponive të tyre.

Përkatësisht neni 4; par 1, nen par 1.23. Mbeturina komunale - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;

1.31. Mbeturina inerte - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

1.31.1. mbeturina inerte qe nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

1.31.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë. Pastaj neni 6 dhe 7 i po këtij ligji i specifikon llojet dhe klasifikimin e mbeturinave sipas katalogut shtetërorë të mbeturinave.

Referuar licencës për administrimin e mbeturinave të personit KRM "UNITETI" Sh.A me nr. i licencës: 147/20 është i autorizuar vetëm për mbledhjen dhe bartje të mbeturinave komunale referuar Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave me kod. Nr. 20 (faqe nr. 10 e këtij UA) dhe se i njëjti nuk

është i autorizuar për bartjen dhe mbledhje të mbeturinave inerte.

Si përfundime vetë procedura e hapur e Tenderit: Nr. i prokurimit 611-22-293-5-2-1, nr. i brendshëm 611-22-006-521 dhe Titulli: Mirëmbajtje e deponis Inerte ka të bëjë më lloje ndryshe të mbeturinave nga licenca që po kontestohet.

Sa për sqarim, dallimi ne mes të këtyre dy licensave është bukur i madh, sepse ne posedojmë dokument te nivelit Qendror, kurse GOE të shpërblyer me kontratë posedojnë Kontratë me Kompaninë Uniteti të nivelit Lokal. Prandaj edhe nuk pajtohem me ketë vendim të AK për te eliminuar kompaninë tone dhe për te shpërblyer me kontratë GOE te pa përgjegjshëm dhe me çmim me te lartë. Vendim i AK është i pa drejte sepse dokumenti i drejtuar ne emër te kompanisë tone ka dukshëm fuqi me te madhe sepse është e nivelit qendror, kurse licensa e GOE të shpërblyer me kontratë është e nivelit lokal dhe është minore ne krahasim me dokumentin tonë, prandaj edhe e kontestojmë ketë vendim arbitrar të AK, për arsye se përben shkelje e nenit 7 të LPP-se.

> Neni 69, Kapaciteti teknik dhe profesional

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka bere shkelje te dispozitave te nenit 69, Kapaciteti teknik dhe profesional, për faktin se shpërblen me kontratë GOE të cilët nuk i posedojnë dëshmitë lidhur me Kërkesat e parapara në Njoftimin për kontrate ne piken III.2.4 dhe në dosje të tenderit 9.1 & 9.2.

Detaje tjera:

Është kërkuar: Të paraqitën Kontratat e shërbimeve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 30,00.00 euro.

Dëshmia: Lista Kontratave - origjinal të natyrës së ngjajshme , të bashkangjitura me kopjet e kontratave, (kopjet e raporteve te pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave - njërën prej tyre) ne 3 vitet e Shkuara, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj nga institucionet publike ose proceset e pranimeve te personat.

Nga Lista e kontratave shihet se të natyrës së ngjajshme mund të mirren vetëm dy (2) referenca.

Referenca e prezantuar ne Liste me numër 18. Pastrimi i deponive te egrra - Faza e dytë =5,801.60 euro dhe

Referenca me numër rendor 19. te prezantuar në Liste, Pastrimi i deponive te egra - Faza e tretë = 988.44 euro, pra gjithsej = 6,790.04 euro.

Referenca e prezantuar ne Liste me numër 12, Eliminimi (largimi) i deponive inerte(te egra) =12,615.67 euro, e perfunduar sipas Fituesit me 18.12.2019, apo sipas planit dinamik 25 ditë, që po del se ka paraqite te dhenat e rrjejshme qe duhet denuar, sepse kjo pune ka përfunduar dhe paguar me 18.12.2018 Nr. protokollit: 400-73756 apo 37 muaj para se te publikohet Njoftimi për kontrate 26.01.2022.Shih faturen e datës 18.12.2018 (nuk

mirret valide)

Referenca e prezantuar ne Liste me numër 26, Pastrimi i deponive faza e dyte = 15,857.33 euro, nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie (nuk mirret valide).

Referenca e prezantuar ne Liste me numër 27, Pastrimi i terreneve, rrafshimi dhe ngjeshja, = 14,960.00 € nëntor 2021 e lëshuar nga udhëheqësi i Grupit, mendojmë se është manipuluese, për faktin se AK është dashur të respektoj dispozitat e nenit 72 të LPP-se dhe te kërkoj sqarime shtese, sepse kjo marrëveshje ne mes te antarëve te grupit është mjafte dyshuese, dhe ne rastet te tilla AK duhet te kërkoj dëshmi nga Banka lidhur me transaksionet, por edhe dëshmi lidhur me lëshimin e faturave te dy këtyre subjekteve dhe deklarimit të atyre faturave ne ATK nga te dy subjektet, prandaj kjo referencë, përderi sa nuk ka fatura te lëshuara, është mjaft dyshuese dhe për ketë marrëveshje, ne do ti drejtohemi me kërkese ne Administratën Tatimore te Kosovës për te sqaruar se a ka transaksione ne mes te këtyre dy subjekteve.

Prandaj, nga këto detaje te dokumentuara mund te konstatohet se GOE të shpërblyer me kontratë GOE "HAZIR TERDEVCI B.I & PROGRESI L.L.C" DRENAS, nuk i plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes, sepse është i papërgjegjshëm dhe vendimi i AK, ne ketë rast përben shkelje te nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pika 1 paragarafi 1.1 i LPP-se.

Prandaj, bazuar ne listën e këtyre kritereve te përzgjedhjes mund te konstatohet se, Kompania jonë "KASTRATI-L" NEKOC-DRENAS është e pergjgjshme i plotëson të gjitha kërkesat e parara ne njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, sepse ka ofruar dokument te besueshëm nga institucionet vendore dhe, ne ketë rast vet AK, KK Drenas duhet te i besoj dokumentit të tille, po ashtu edhe kemi çmim me te ulët dhe si e tille oferta jone duhet të shpërblehet me kontratë.

Përfundim: Kërkojmë nga OSHP, që:

- Të aprovoj Ankesën të bazuar;
- Të anuloj Vendimin e AK për dhënie të kontratës;
- Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjes së tenderit, LPP si dhe Rregullat dhe RRUOPP. Të detyroj AK të na shpall fitues të këtij aktiviteti sepse jemi të pergejgshem dhe kemi ofruar çmimin më të ulët.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

		Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

		1.Kërkesat përshtatëshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5.	**1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal**
		2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit	**2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, ji me te vjeter se 90 dite (vetem per OE fitues) - kopje.**
		3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike	**3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetem per OE fitues) – origjinal apo e noterizuar jo ma e vjeter se 6 muaj**
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **5.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**
		2. Rexhistrimi i numrit fiskal	**6.Kopja e numrit fiskal**
		3. Rexhistrimi në TVSH	**7.Kopje e Rexhistrimit në TVSH**
		4. Licencë për menaxhim të mbeturinave ose Kontrate per deponim te mbeturinave me nje kompani te Lincensuar-valide	**8. OE duhet të jetë i lincencuar me licencë për menaxhim te mbeturinave –leshuar nga Ministria e planifikimit Hapesinor dhe Mbrojtjes se Mjedisit ose kontrate per deponim te mbeturinave me nje kompani te licencuar per menaxhim te mbeturinave-kopje**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **N A**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **N A**
Kërkesat mbi mundësitë teknike	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Të paraqitët stafi që do të angazhohet në ketë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Lista e stafit - Origjinal Për të gjitha kërkesat rreth stafit të mesem duhet të ofrohen dëshmitë kontratat kopje, për stafin profesional (inxhinierin) kontrata ose**

dhe/ose profesio nale		**punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum punonjës 3 , Menaxheri i projektit të jetë ingjinier ose bachelor i ekologjis me diplomë i caktuar me një vendim, CVI-ja**	**marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës , CVI-ja - kopje .**
		Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) një bager , një lugë ngarkuese dhe një greder) ,Nje Kamion me kapacitet minimumin 8 ton	**2.Lista e paisjeve - Origjinal për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (kopjet e librezave , fatura)-njera prej tyre , DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre me qera**
		3.Të paraqitën Kontratat e sherbimëve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 30,00.00 euro	**Lista Kontratave – origjinal të natyrës së ngjajshme , të bashkangjitura me kopjet e kontratave , (kopjet e raporteve te pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave - njeren prej tyre) ne 3 vitet e Shkuara, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj nga institucionet publike ose proceset e pranimeve te personat privat.**
		Caktimi i Menaxherit për këtë projekt	**Vendimi mbi caktimin e Menaxherit për këtë projekt – Origjinal.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 07.03.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna e Gllogocit, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas, në vlerë totale prej 29,837,50 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Komuna e Gllogocit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë –punë me një operator ekonomik, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me

Çmimin më te ulët, vlerë e mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të ofertës të opertaorit ekonomik ankues dhe propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorve ekonomik **"Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas,**

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Kastrati -L"-Drenas

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojm se OE ankues "Kastrati -L"-Drenas, pretendon se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59,60 dhe 69 të LPP-së, si dhe Ligjin Nr. 04/L-60 për Mbeturinat neni 4, parag 1, nen par. 1.23, neni 6 dhe 7 të këtij ligji, duke e eliminuar OE ankues me arsyetimin si në letrën standarde të datës 07.03.2022, në të cilën thuhet: ***"Mungon licenca e OE të cilën e ka në kontrate".***

Lidhur me këtë pretendim, dhe arsyetimin e eliminimit të AK-së ekspertja shqyrtuese sqaron se në mesin e kërkesave të AK-së, tek **Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7**: AK ka kërkuar si në vijim:

Kërkesa 4. Licencë për menaxhim të mbeturinave ose Kontrate per deponim te mbeturinave me nje kompani te Lincensuar-valide

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

8. OE duhet të jetë i lincencuar me licencë për menaxhim te mbeturinave –leshuar nga Ministria e planifikimit Hapesinor dhe Mbrojtjes se Mjedisit ose kontrate per deponim te mbeturinave me nje kompani te licencuar per menaxhim te mbeturinave-kopje

Operatori ekonomik ankues "Kastrati -L"-Drenas, lidhur me ketë kërkesë ka prezantuar kontratën për shërbim me **Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A (KMDK),** me nr.protokollit 06./04/23 të datës 08.03.2021 e vlefshme deri me datë 08.03.2022. Lidhur me këtë dëshmi, autoriteti kontraktues me date 25.02.2022, ka kërkuar nga OE ankues "Kastrati -L"-Drenas, si dëshmi të prezantoj edhe **Licencen e operatorit ekonomik** të "Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A" , me te cilën OE ankues ka kontratë nr.protokollit 06./04/23 të datës 08.03.2021, dhe njëherit ju ka drejtuar edhe Kompanisë për Menaxhmin e Deponive në Kosovë Sh.A. (KMDK). Kurse, KMDK i kthen përgjigje AK-së duke i sqaruar se kompania "N.T.SH. Kastrati-L" ka kontratë shërbimi me KMDK SH.A, ndërsa lidhur me pyetjen e AK-së që ka të bëjë me licencë, KMDK i ka sqaruar AK-së, se KMDK është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës e cila është pronare aksionare me kapital publik, si dhe i ka bashkangjitur një shkresë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas të cilës shkresë thuhet: *"Meçense procesi i shqyrtimi dhe dhënies së Lejes Mjedisore të Integruar kërkon një*

kohë të konsiderushme MMPH njofton se KMDK , si kompani publike e nivelit qendror deri në marrjen e LMI mund të operoj dhe të kryej funksionin e saj në deponitë ekzistuese në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e deponive sanitare."

Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të statutit të KMDK-së, vendimit të qeverisë për themelimin e kësaj ndërmarrje publike, vlerëson se AK do duhej që ti drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktuës më kërkesë për informata nëse KMDK (Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë) posedon licencë ashtu siç ka kërkuar vetë AK në dosje të tenderit. Pra duke pasur parasysh që KMDK është ndërmarrje publike dhe pronare e kësaj kompanie është Qeveria e Kosovës, dhe në anën tjetër MMPHI është kompetente për licencimin dhe kontrollin e kësaj veprimtarie, konsiderojmë se AK gjatë ri vlerësimit ne kuptim të nenit 72 të LPP-së, do duhet ti drejtohet MMPHI-së me kërkesë për informata nëse KMDK posedon licencën ashtu siç ka kërkuar vetë AK në dosje të tenderit.

Si prove se bashku me raport gjeni kopjen shkresën me numër prot.2524-2/R të datës 12.10.2012 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe kontratën e OE "Kastrati -L"-Drenas, për shërbim me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A (KMDK), me nr.protokollit 06/04/23

Në vijim po i trajtojmë pretendimet ankimore të OE ankues "Kastrati -L"-Drenas kundrejt ofertës së grupit të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës "Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas, ku i njëjti pretendon se vetëm dy nga kontratat/referencat e prezantuara nga grupit i OE të rekomanduar për kontratë janë të natyrës së ngjajshme, ndërsa referenca e prezantuar me nr. 12, 26, dhe 27 i konteston.

Sqarojm se AK tek **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1& 9.2** përkatësisht kërkesën nr.3 ka kërkuar si në vijim:

3.Të paraqitën Kontratat e sherbimëve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 30,00.00 euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista Kontratave – origjinal të natyrës së ngjajshme , të bashkangjitura me kopjet e kontratave , (kopjet e raporteve te pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave - njeren prej tyre) ne 3 vitet e Shkuara, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj nga institucionet publike ose proceset e pranimeve te personat privat.

Sqarojm se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar listën e projekteve si të realizuara, me gjithsej njëzet e shtatë (27) projekte të përshkruara, ku në mesin e tyre ka edhe kontrata të cilat janë pa referenca ose nuk janë brenda periudhës 3 vite nga data e njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar ne paramasen e AK-së dhe pozicionet në ketë paramas kontrata e prezantuara nga OE i rekomanduar të mbështetura në referenca mbulojnë dhe tejkalojnë kërkesën e autoritetit kontraktues, sikurse rasti i kontratës së lidhur me AK KK Skenderaj në vlerë 59,242.38 euro e datës 02.10.2019, ku për këtë kontratë gjendet edhe referenca e lëshuar me datë 27.01.2021 nga AK KK Skenderaj. Po ashtu janë edhe kontratat tjera që mbulojnë kërkesën e AK-së, sikurse kontratat/referencat me numër 18, 19, 24, etj...

Si prove se bashku me raport gjeni kopjen listën e kontratave të prezantuar në ofertën e OE "Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas dhe kontratën/referencën me AK KK Skenderaj

Sa i përket pretendimit të OE ankues i cili i konteston referencat e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrat si kontratat me nr. 12, 26, dhe 27 eksperti shqyrtues sqaron se AK lehtësisht ka mund të verifikoj këto referenca dhe kontrata pasi shum nga kto referenca janë po me të njetinë autoritet kontraktues komunën e Gllogocit. Pra AK mund të kerkoj sqarim shtesë dhe lejohet ofrimi i sqarimit për situatë të tillë konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39 të RrUOPP-së.

Gjithashtu, autoriteti kontraktues ka kërkuar ***"Kontratat e sherbimëve të natyrës se ngjajshme"***, andaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues se vetëm dy nga kontratat/referencat nr.18 dhe 19 të prezantuara nga grupit i OE të rekomanduar për kontratë janë të natyrës së ngjajshme.

Kontratat e prezantuara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë janë të natyrës së ngjashme dhe njërit sqarojmë se ne dosjen e tenderit AK-ja, nuk ka kërkuar kontrata të natyrës se **njëjtë.**

Lidhur me pretendimi e OE ankues se licenca e prezantuar nga grupit i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës "Hazir Terdevci B.I & Progresi L.L.C" –Drenas, me KRM "Uniteti" **nuk është** licencë për menaxhimin e mbeturinave inerte dhe i njëjti nuk është i autorizuar për bartjen dhe mbledhje të mbeturinave inerte. Ekspertja shqyrtues sqaron se autoritetit kontraktues tek **Kërkesa 3. ka kërkuar *"Licencë për menaxhim të mbeturinave ose Kontrate për deponim te mbeturinave me një kompani te Lincensuar-valide",*** por nuk ka specifikuar llojin e licencës për mbeturina, mbeturina interne apo mbeturina

komunale - mbeturina nga amvisëritë ashtu siç pretendon OE ankues, rrjedhimisht AK i ka vlerësuar ofertat në bazë të nenit 59 të LPP-së.

Si prove se bashku me raport gjeni kopjen kontratën në mes të OE të rekomanduar për kontratë me KRM "Uniteti" SH.A si dhe licencës nr.147/20 nga Ministria e Ekonomis dhe Ambientit

Përfundimisht, ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si me larte, rekomandimi ynë për AK – Komuna Gllogocit, është që lenden ta kthej në ri vlerësim me qellim qe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të vete aplikuara ne dosje te tenderit, konform dispozitave të LPP-së, në tersi dhe në veçanti nenit 72.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, propozimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **Ri vlerësim**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gllogocit.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Kastrati -L"-Drenas